

## **Informacion për mbrojtjen e të Dhënave Personale**

**Lufthansa Industry Solutions Shpk**

Sheshi „Italia”, Arena Center, Hyrja D, Kati 4, Tiranë,  
Shqipëri

29.01.2021

Informacioni në vijim për mbrojtjen e të dhënave personale përmban standartet më të larta të transparencës bazuar në ligjin shqiptar nr. 9887 datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, Udhëzimin Nr. 42 datë 22.07.2014, “Për përpunimin e të dhënave personale të kandidatëve për punë” dhe Rregulloren e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave të BE (GDPR).

### **Cili është kontrolluesi?**

Në paragrafët në vijim, ne, Lufthansa Industry Solutions shpk, person juridik i themeluar në përputhje me legjislacionin shqiptar me NUIS nr. L71513046P, (në vijim referuar si “LHIND”, “ne”, “kontrolluesi”), pasqyrojmë informacionin lidhur me përpunimin e të dhënave tuaja personale kur ju përdorni faqen web [lhind.al](http://lhind.al).

### **Kë mund të kontaktoj?**

Nëse keni pyetje për mbrojtjen e të dhënave personale lidhur me faqen web ose me shërbimet e ofruara në të, mund të kontaktoni Personin e Kontaktit për të Dhënat Personale të Kontrolluesit:

Znj. Liridona Cani (Raza)

Adresë email: [liridona.raza.cani@lhind.dlh.de](mailto:liridona.raza.cani@lhind.dlh.de)

Adresë postare: Sheshi Italia, Arena Center, H.D, K.4, Tiranë.

### **Si përpunohen të dhënat?**

Të dhënat personale përpunohen fillimisht në Gjermani nga Lufthansa Industry Solution GmbH & Co. KG (në vijim referuar si “Përpunuesi”) person juridik i themeluar në përputhje me legjislacionin gjerman me NUIS nr. HRB 3688 NO e cila i transferon të dhënat më pas pranë Kontrolluesit. Lufthansa Industry Solution GmbH & Co. KG i përpunon të dhënat për të njëjtën kohëzgjatje që zbaton Kontrolluesi.

Nëse keni pyetje për procedurën e përpunimit të dhënave nga Lufthansa Industry Solution GmbH & Co. KG mund të kontaktoni Personin e Kontaktit të Kontrolluesit Znj. Liridona Cani (Raza), ose Përpunuesin, nëpërmjet adresës së emailit:

E-Mail: [datenschutz@dlh.de](mailto:datenschutz@dlh.de)

Adresë postare: Zyra e informacionit, Schützenwall 1, D-22844 Norderstedt, Gjermani

### **Për çfarë qëllimesh i përpunojmë të dhënat tuaja dhe cila është baza ligjore?**

Ne përpunojmë të dhënat bazuar në parashikimet e ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe Udhëzimin Nr. 42 datë 22.07.2014, “Për përpunimin e të dhënave personale të kandidatëve për punë”.

Ne përpunojmë të dhënat bazuar në dhënien e pëlqimit nga ana juaj në përputhje me nenin 6 paragrafi 1.a të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe nenin 6 paragrafi 1.a të GDPR, për qëllime të përcaktuara, konkretisht:

- për qëllim të vlerësimit të kandidaturës tuaj për tu punësuar;
- për të ju kontraktuar;
- për të ju kontaktuar.



Të dhënat personale do të mbahen dhe përpunohen në bazë të vullnetit tuaj dhe jo nëpërmjet një detyrimi të përcaktuar në aktet ligjore ose nënligjore.

Dhënia e pëlqimit mund të tërhiqet në cdo kohë. Tërheqja e dhënies së pëlqimit ka efekt vetëm për të ardhmen dhe nuk ka efekt në ligjshmërinë e përpunimit të të dhënave deri në datën e tërheqjes së pëlqimit.

Të dhënat personale nuk do të përdoren për shkaqe të tjera të cilat nuk përputhen me qëllimin e mbledhjes.

### **Ç'farë të dhënash personale jeni të detyruar të jepni?**

Ne kemi vendosur shenja dalluese në fushat e formularit të aplikimit në faqen web të cilat janë të detyrueshme për tu plotësuar, në mënyrë që të kemi mundësinë të vlerësojmë kandidaturën tuaj për tu punësuar ose të kemi mundësi për të ju kontraktuar.

Kur ju jepni pëlqimin, të dhënat e mëposhtme nga formulari i aplikimit dërgohen pranë kontrolluesit dhe përpunohen:

- Emri
- Mbiemri
- Titulli (opsionale)
- Adresa Email
- Telefoni (opsionale)
- Emërtimi i kompanisë
- Vend i punës (opsionale)

Pëlqimi juaj për përpunimin e të dhënave merret gjatë procesit të regjistrimit, kohë në të cilën kjo deklaratë për të dhënat personale sillet në vëmendjen e përdoruesit

Të dhënat e përpunuara nëpërmjet formularit të aplikimit nuk i bëhen të njohura palëve të treta. Të dhënat përdoren vetëm për qëllim të vlerësimit të kandidaturës tuaj për tu punësuar dhe për të ju kontraktuar.

### **Sa kohë mbahen të dhënat tuaja?**

Të dhënat tuaja fshihen në rastin kur nuk është më e nevojshme mbajtja e tyre për qëllimet e parashikuara, por në cdo rast nuk mbahen për një kohëzgjatje më të gjatë se (2) dy vite.

### **Ç'farë të drejtash keni për të mbrojtur të dhënat personale?**

LHIND vlerëson që është e rëndësishme që procedurat për përpunimin e të dhënave të jenë të drejta dhe transparente. Në këtë mënyrë besojmë që personat të cilëve i përpunohen të dhënat duhet të kenë mundësinë të ushtrojnë ndër të tjera të drejtat e mëposhtme:

- E drejta për akses, Neni 12, Ligji nr. 9887 datë 10.03.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale" dhe Neni 15 i GDPR;
- E drejta për të kërkuar bllokimin, korrigjimin ose fshirjen, Neni 13, Ligji nr. 9887 datë 10.03.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale" dhe Nenet 16 dhe 17 të GDPR;

- E drejta për të kundërshtuar, Neni 15, Ligji nr. 9887 datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale” Neni 21 i GDPR;
- E drejta për t'u ankuar, Neni 16, Ligji nr. 9887 datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale dhe Nenet 77, 78 dhe 79 të GDPR;
- Kompensimi i dëmit, Neni 17, Ligji nr. 9887 datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe Neni 82 i GDPR;

Për të ushtruar këto të drejta, ju mund të kontaktoni kontrolluesin nëpërmjet Znj. Liridona Cani (Raza), Person Kontakti për mbrojtjen e të dhënave personale Ju duhet të dërgoni informacionin e mëposhtëm për qëllim identifikimi:

- Emër
- Mbiemër
- Adresë E-mail
- Kopje e kartës së identitetit

Nëse do të dërgoni kopjen e kartës së identitetit, ju lutemi që mbulonit të gjitha të dhënat, përveç emrit dhe mbiemrit.

Ju sjellim në vëmendje që për të shqyrtuar kërkesën tuaj dhe gjithashtu për qëllim identifikimi, ne do të përpunojmë të dhënat personale bazuar në nenin 6 paragrafi 1.a dhe ç të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe në nenin 6 paragrafi 1.c të GDPR.

### **Informacion për të drejtën tuaj të aksesit**

Çdo subjekt i të dhënave ka të drejtë që pa pagesë, nëpërmjet kërkesë me shkrim, të marrë nga Kontrolluesi:

- a) konfirmimin nëse të dhënat personale po i përpunohen ose jo, informacion për qëllimin e përpunimit, për kategoritë e të dhënave të përpunuara dhe për marrësit e kategoritë e marrësve, të cilëve u përhapen të dhënat personale;
- b) në një formë të kuptueshme, të dhënat personale dhe informacionin e disponueshëm për burimin e tyre;

Informacioni për të dhënat komunikohet në formën, në të cilën ishin në kohën kur është bërë kërkesa. Kontrolluesi, brenda 30 ditëve nga data e marrjes së kërkesës, informon subjektin e të dhënave ose i shpjegon atij arsyet e mosdhënies së informacionit.

Në rast se aksesit mohohet, duke argumentuar se çënohen interesat e sigurisë kombëtare, politika e jashtme, interesat ekonomikë dhe financiarë të shtetit, parandalimi dhe ndjekja e veprave penale ose liria e shprehjes dhe informimit apo liria e shtypit, subjekti i të dhënave mund t'i kërkojë Komisionerit të kontrollojë përjashtimin në rastin konkret. Komisioneri informon subjektin e të dhënave për masat e marra.

**Informacion për të drejtën tuaj për të kërkuar bllokimin, korrigjimin ose fshirjen**

Çdo subjekt i të dhënave ka të drejtë të kërkojë bllokimin, korrigjimin ose fshirjen e të dhënave pa pagesë, kur vihet në dijeni se të dhënat rreth tij nuk janë të rregullta, të vërteta, të plota ose janë përpunuar dhe mbledhur në kundërshtim me ligjin.

Kontrolluesi, brenda 30 ditëve nga data e marrjes së kërkesës së subjektit të të dhënave, duhet ta informojë atë për përpunimin e ligjshëm të të dhënave, kryerjen ose moskryerjen e bllokimit, korrigjimit apo të fshirjes. Kontrolluesi informon marrësin e të dhënave personale për korrigjimin ose fshirjen e të dhënave personale, të transmetuara para korrigjimit apo fshirjes.

Kur kontrolluesi nuk bën bllokimin, korrigjimin ose fshirjen e të dhënave të kërkuara prej tij, subjekti i të dhënave ka të drejtë të ankohet te Komisioneri.

Kontrolluesi kryen vetë ose me kërkesë të subjektit të të dhënave bllokimin, korrigjimin ose fshirjen e të dhënave personale, kur vëren se janë të parregullta, të pavërteta, të paplota ose janë përpunuar në kundërshtim me ligjin.

**Informacion për të drejtën tuaj për për t'u ankuar dhe kompensimin e demit**

Çdo person që pretendon se i janë shkelur të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshëm për të dhënat personale, ka të drejtë të ankohet ose të njoftojë komisionerin dhe të kërkojë ndërhyrjen e tij për vënien në vend të së drejtës së shkelur. Pas këtij ankimi, në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, subjekti i të dhënave mund të ankohet në gjykatë.

Në rast se subjekti i të dhënave ka bërë ankim, kontrolluesi nuk ka të drejtë të ndryshojë të dhënat personale deri në dhënien e vendimit përfundimtar.

Çdo person, të cilit i është shkaktuar një dëm, si rezultat i përpunimit të paligjshëm të të dhënave personale, ka të drejtë t'i kërkojë kontrolluesit kompensim, sipas rregullave të përcaktuara në Kodin Civil.

**Kufizime të përdorimit të udhëzimeve për mbrojtjen e të dhënave personale**

Udhëzimet e mësipërme për mbrojtjen e të dhënave personale kanë si objekt vetëm përpunimin që realizohet nëpërmjet kësaj faqe web. Udhëzimet për mbrojtjen e të dhënave personale nuk rregullojnë veprimtarinë e faqeve të tjera web, të cilat parashikojnë udhëzimet e tyre të posacme për mbrojtjen e të dhënave personale.